

# SHQIPTARËT E DALLASIT EDHE KUR



E diela që sapo kaloi i gjeti shqiptarët e Dallasit në hapësirën e paanë të Parkut "Mckinnish". Në këtë lëndinë nisën lojrat e voleybolit dhe sporteve të tjerë.

## Nga Gjekë Marinaj

**Q**ë pa u afruar mirë e pamë se Parku "Mckinnish," një lëndinë e lulëzuar sipas shijeve të lulishtarëve më me zë të qytetit të Dallasit, qe subjekti i një bukurie krejt të veçantë në ditën e parë të këtij Maji. Në gjirin e ngrohtë të një dite të kthjellët pranverore, parku ua kishte lëshuar hapësirën e gjelbër luleve shumëngjyrëshe që mbretëronin aty. Vetëm kur u afruam mundëm t'ia zbulonim atij sekretin ditës: lulet e atyshme nuk ishin vetëm botanike por edhe humane. Disa dhjetëra fëmijë shqiptarë, që nga fanellat që kishin veshur dukeshin si lulëkuqe të freskëta, ishin bërë pjesë e konglomeratit hijeshues të parkut. Por as trëndafilat e bollshëm ndanë rrugicave kaluese nga njëri cep te tjetri nuk u gjetën të vetme—mes tyre ishin bërë buqetë nënat e fëmijëve që sapo folëm. As burrat shqiptar, nuk mund të lihen të pa poetizuar për prezencën e tyre në park—ata sikur kishin diçka të përbashkët me pemët e mëdha, me shëndetin dhe krenarinë pushtuese hijeve, me fuqinë mbrojtëse të familjeve të tyre qoftë edhe nga dielli i mesditës.

Hymë në park dhe i pamë pothuajse të gjitha aspektet e jetës të gjallëroheshin nga goditjet e notave të muzikës shqiptare. Ne të katër anët e parkut ishin vendosur altoparantë të mëdhenj, të cilët fuqizoheshin nga bateritë e makinave të pjesëmarrësve. Tingujt e bukur muzikorë që shpërmdaheshin prej tyre kishin efekte të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Tek disa kishin zgjuar ndjenja përmallimi. Ajo dukej nga shikimi i tyre i hedhur diku larg, por jo në ndonjë pikë të veçantë, nga ajo pamja e fytyrës që dashje-pa-dashje reflekton meditimin.

Një grup shqiptarësh që ishin grumbulluar afër tendës së ushqimeve të shpejta, po shoqëronin muzikën me lëvizjet e trupit tek prisnin në radhë për ato që dëshironin të blinin. Ndërsa ata më të rinjtë, të kapur dorë për dorë po hidhnin valle popullore kosovare. Madje edhe ata që në pamje të parë dukej se muzika për ta nuk kishte as rëndësinë më të vogël dukeshin të kënaqur ngaqë familjet e tyre po bënin qejf.

Por kishte nga ata që i kishin mbyllur veshët ndaj muzikës së regjistruar. E kemi fjalën për një grup muzikantësh, të cilët preferonin të luanin diçka nga krijimtaria e tyre në vend që të dëgjonin kompozimet e të tjerëve. Një treshe elegante në kuptimin e tingujve që prodhonin, por disi të

çuditshëm në kombinimin e instrumenteve. Një sharki, një violinë dhe një kitarë përbënin botën e tyre argëtuese për veten dhe të tjerët.

Natyrisht kishte edhe nga ata që këndonin pa shoqërimin e ndonjë vegje muzikore. Ishin një grup të njohurish të zotit Moni Kaba. Ato po këndonin në ditëlindjen e 55-stë të tij, këngën "Happy Birthday to You". Aty pran tij gjendej edhe Gani Vraniqi, i cili nuk dëshironte t'na e tregonte moshën e tij në vite, por vetëm në muaj: "Jam 792 muaj" tha ai me të qeshur. Edhe ai si Moni kishte ardhur të kalonte një ditë të bukur në piknik të shqiptarëve me familjen, miqtë dhe bashkatdhetarët e tij.

Duartrokitjet e shumta dhe të shpeshta që një grup të rinjsh po jepte aty pranë, nuk mund të ishin për ditëlindjen e Monit, sepse ato po jepeshin edhe pas duartrokitjeve që u dhanë për këngën e ditëlindjes. Të shtyrë nga kurioziteti, u afruam, dhe për çudinë tonë, një djalë 14-vjeçar, të cilin e quanin Rizvan Ceka, po bënte një soj akrobacie me një top futbollit, sa disa njerëzit aty pranë nuk hezituan të shpreheshin se ai ka potencialin që një ditë të bëhet Maradona i Shqipërisë në futboll. Ishte vërtet fenomenal në veprimet e tij me topin. Duhej ta shihje ta besojë. Kur u njoftua se ne do të



bënim një shkrim rreth piknikut për gazetën Illyria, ai me kënaqësi shprehu ëndrrën e tij: "Shpresoj që një ditë të vesh fanellën e ekipit të kombëtares dhe ta mbaj me dinjitet atë. Në emër të Illyria-së uruam që ëndrra e tij të behej realitet.

Ndonëse jo në nivelin e tij profesional, në disa fusha të parkut, meshkuj e femra të moshave të ndryshme po luanin futboll. Kërkimet për topin në shqip, shqiponja dykrenore në fanellat e tyre të kuqe, thirjet inkurajuese në dialekte të ndryshme nga shikuesit anës së fushës e bënin atë pjesë të aktivitetit të dukej me serioz se ç'ishte. "Po bëjmë qejf," po i tregonte një shoqeje Bora Laçi, një vajzë 13-vjeçare nga Korça, e cila, siç u informuan, kishte fituar një konkurs në shkollë amerikane për klasën e saj. Të njëjtën nderim kishte shijuar edhe vëllai i saj Igli, i cili ndonëse ishte dy vjet më i rritur se Bora ata ishin nxënës të së

njëjtës klasë.

Në çast, disa brohoritje të mëdha dëgjuam nga ana jugore e parkut, na e tërhoqën vëmendjen. Një grup meshkujsh na tregoi një grup femrash në anën tjetër po provonin forcën e tyre tërheqëse në sportin e tërheqjes së litarit. "E shikon femrat fituan," tha me entuziazëm Sofi Kusari. "Është aktiviste e komunitetit tonë," na tha Gëzim Laçi. "Ajo po bën një punë të mirë me fëmijët e shqiptarëve të Dallasit duke i veshur herë pas here me kostum kombëtare dhe duke i aktivizuar ata me aktivitetet e ndryshme kulturore," shtoi Gëzimi.

Ndërsa ata që kishin më shumë energji vazhdonin ta kalonin kohën sipas mënyrës së tyre të bërjes qejf, nga orët e vona të mesditës, shumë nga shqiptarët kishin mbledhur familjet e tyre nën hijet e pemëve të mëdha dhe po vazhdonin të hanin drekë



Tërheqja e litarit, ishte me të vërtetë një nga garat më interesante që u ndoq me emocion dhe u duartrokit.



Ndoshta një ditë këto vajza do të takohen sërish dhe kjo fotografi kujtimi do t'u rikujtojë emocionet e kësaj ditë plot mbresë.



TAZH

# NUK BËJNË ASGJË BËJNË DIÇKA...



Të gjithë së bashku u fotografuan enkas për në faqet e gazetës së tyre "Illyria".



Nga e majta, Nazar Mehmeti-kryetar i shoqatës "Illyria", Bruno Ceka dhe Bari Meçollari

buzëqeshje të çiltër deri në fund. "Kjo nuk do të thotë se ne vijmë këtu vetëm për të takuar djem, por mundësi i njohjes me djem nga e njëjta kulturë, e njëjta gjuhë, nga të njëjtat interesa familjare është diçka e bukur jo vetëm për ne të rinjtë, por edhe për prindërit tanë, për mendjet më të qeta të tyre ndaj nesh," ndërhyri Besa me po aq çiltërsi sa Valbona.

Me kënaqësinë që të jep një emancipim i tillë i femrës shqiptarë, u larguam për t'u takuar me Kryetarin e shoqatës Illyria, Nazar Mehmeti. Duke qenë të njohur me aftësitë e tij organizative për kësajsoj aktivitete, qemë të bindur se tek ai do të gjenim një informacion të saktë rreth këtij aktiviteti. Nazari na shpjegoi se shoqata e tij tashmë nuk e organizon piknikun vetëm një herë në vit si dikur, por a bën atë për çdo muaj, përveç muajve kur është shumë ftoftë apo kur bën shumë vapë. Ai na informoi se komuniteti shqiptar i Dallasit, ka rreth 3000 banorë dhe se pjesëmarrja kishte ardhur në rritje, sa sot ai kishte numëruar mbi 300 vetë, ku do të thotë rreth 10 për qind e krejt popullsisë.

Aty pranë ishte edhe Bruno Ceka. Brunoja e vlerësonte piknikun për anën edukuese të të rinjve me vlerat kombëtare. Sipas tij, veshja me fanellat e

kuqe, ku është i shtypur flamuri ynë, bisedat në gjuhën e përbashkët shqipe, e njohja me njëri tjetrin shërbejnë si një medikament për të shëruar mallin ndaj vendlindjes, por edhe për të shtuar dashurinë e të rinjve ndaj saj. Ylber Korça, shprehu entuziazëm rreth takimit me një shqiptar që ishte agent i një kompanie që afronte inshurencë për jetën, shtëpitë dhe makinat. "Pse të mos bëj biznes me një shqiptar, kur është e mundur," tha ai.

Luli Shpati tek po miratonte me kokë, shtoi se "ky takim i ndihmon të rinjtë edhe në një mënyrë tjetër; i largon ata nga aktivitetet që mund të jenë të rrezikshme për ta dhe për shoqërinë. Këtu i kemi fëmijët para syve dhe gjithçka mbetet nën kontroll".

Natyrisht Luli kishte të drejtë. Me dhjetëra fëmijë mbushnin parkun e bukur me zëra fëmijërorë, goditje topash, vrapime etj. Ca vërtiteshin me akullore në duar, ca me hamburgerë, e shumica me shishe uji për të shuar etjen. Por, për kënaqësinë e të gjithëve, fëmijët nuk hidhnin mbeturina nëpër tokë. Edhe kur ata më të vegjlit e bënin pavetëdije një gjë të tillë, ata më të rriturit i korrigjonin gabimet e tyre duke i mbledhur dhe hedhur ato në koshat e caktuar. Gjë e cila u

kishte rënë në sy shumë njerëzve përfshi këtu edhe Muhamet Qerimin e Gezim Veselin, të cilët po i inkurajonin fëmijët që kishin rreth tyre për ta vazhduar nisimën e tyre të bukur deri në fund të piknikut.

Megjithatë ndër të pakët, zoti Bari Meçollari, u shpreh për gazetën Illyria se sot ai ndjehej disi i huaj në këtë piknik. Nostalgjia e tij ishte për Çikagon, ku ai kishte kaluar një pjesë të mirë të jetës. "Kam rreth 4 vjetësh këtu në Dallas, dhe akoma më mungon komuniteti shqiptar i Çikagos," pohoi ai. Por Zoti Meçollari, nuk hezitoi të vlerësoi ditën e parë të Majit 2005, si një nga ditët më të këndshme të kohës së tij Dallas.

Dhe kështu, në orët e vona të pasdites, Parku "Mckinnish," filloi të mbetet i vetëm në bukurinë e tij botanike. Përsëritet, përfaqimet, lamtumirat e bëra me dorë nga larg the afër që shqiptarët i jepnin njëri tjetrit, të lenin të kuptojë harmoninë njerëzore midis tyre, dashurinë për atdheun, përpjekjen për t'u rritur së bashku nën ombrellën e kulturës sonë kombëtare, e pse jo, edhe dëshirën për t'u takuar sa më parë në të njëjtin vend. Këta janë shqiptarët e Dallasit. Ata edhe kur duket se nuk bëjnë asgjë bëjnë diçka: bëjnë qejf së bashku.

me atë oreksin që të jep një ditë e freskët Maji. Aty këtu kishte edhe grupe të mëdha burrash të cilët ua kishin lënë grave atë "hapësirë e nevojshme" dhe duke u mbledhur të bënin muhabet burrash, gratë tyre bënin të njëjtën gjë të shkëputura k, por jo larg tyre.

Siç pritet në tubime të tilla defrimi, edhe të herë humori ishte pjesë e pandarë tivitetit. Në grupin ku bënte pjesë Hamit jro të qeshurat ishin me zë të lartë dhe a larg sugjeronin kënaqësi midis tyre. U ruam. Pasi i përshëndetëm, i pyetëm nëse shihin dëshirë ta ndanin me ne atë pjesë të imorit që atyre po ua bënte ditën aq të ikur. "E pse jo," tha Hamiti me një çiltër, që është karakteristike për ne shqiptarët. Ne po flisnim se si ushqimet këtu në merikë nuk e kanë atë shijen që kanë shqimet në atdhe. Të vetmet gjëra që nuk kanë humbur shijen, por ndoshta e kanë

përmirësuar atë janë... o, s'ka nevoja të ta them, ju e dini se ku e kam fjalën..." përfundoi ai i shoqëruar me të qeshura edhe më të mëdha nga grupi ku ai bënte pjesë.

Me esencën e atij humori të këndshëm në mendje kaluan në anën tjetër ku ishin një grup grash dhe vajzash. Interesit tonë se çfarë flasin nënat dhe motrat tona kur janë në mungesë të pranisë së burrave dhe djemve të tyre, i erdhi në ndihmë zonja Safete Alili. "Ne jemi pak ndryshe nga burrat tanë kur bisedojmë së bashku. Bisedat tona sillen drejt rritjes më të mirë të fëmijëve, drejt mundësisë për realizimin e ëndrrave të tyre në jetë, si t'i risim ata me të vyer për shoqërinë dhe për veten e vet etj.," tha me një zë të besueshëm ajo. Menjëherë u dëgjua zëri i dy vajzave të reja, Valbonës dhe Besës, që ishin pjesë e këtij grupi. "Pikniku na krijon mundësinë të njihemi me djem shqiptar," shtoi e para me një



Sërisht një lojë me top...



Asgjë nuk mungoi aty në parkun e bukur, edhe tregtarët shqiptarët sollën mallrat e tyre